



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**KOMISIONERI**

Nr. 1574/1 prot.

Tiranë, më 19.08. 2026

**V E N D I M**

**Nr. 223 , datë 19. 08. 2026**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenet 32 dhe 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar mori në shqyrtim ankesat: nr. 134 Regj., datë 03.06.2026, paraqitur nga D.L; nr. 136 Regj., datë 08.06.2026, paraqitur nga R.B; nr. 139 Regj., datë 09.06.2026, paraqitur nga M.G; nr. 140 Regj., datë 10.06.2026, paraqitur nga N.M; nr. 141 Regj., datë 10.06.2026, paraqitur nga I.S; nr. 142 Regj., datë 10.06.2026, paraqitur nga S.Ç; nr. 143 Regj., datë 10.06.2026, paraqitur nga G.T; nr. 144 Regj., datë 11.06.2026, paraqitur nga D.Ç; nr. 145 Regj., datë 12.06.2026, paraqitur nga A.Q; nr. 148 Regj., datë 16.06.2026, paraqitur nga R.A; nr. 152 Regj., datë 18.06.2026, paraqitur nga M.A; nr. 159 Regj., datë 25.06.2026, paraqitur nga A.M dhe nr. 169 Regj., datë 13.07.2026, paraqitur nga D.S, kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, në të cilat pretendohet diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave të sipërcituara, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, respektivisht subjektet, parashtrojnë si më poshtë vijon:

1. **Z. D.L**<sup>2</sup>, është person me aftësi të kufizuar i Grupit të II-të dhe për vitin akademik 2025-2026 është student i vitit të parë, i regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Shërbim Social”, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfitues në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
2. **Znj. R.B**<sup>3</sup>, është person me aftësi të kufizuar e Grupit të I-rë dhe për vitin akademik 2025-2026 është studente e vitit të parë, e regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Ankesa nr. 134 Regj/2026.

<sup>3</sup> Ankesa nr. 136 Regj/2026.

*kohë të plotë”, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Dega Shërbim Social, në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfituese në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.*

3. **Znj. M.G<sup>4</sup>**, është person me aftësi të kufizuar e Grupit të II-të dhe për vitin akademik 2025-2026 është studente e vitit të dytë, e regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Teknika e prodhimit të farave e fidanëve”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfituese në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
4. **Znj. N.M<sup>5</sup>**, është person me aftësi të kufizuar e Grupit të I-rë dhe për vitin akademik 2025-2026 është studente e vitit të dytë, e regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Menaxhim Biznesi Bujqësor”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfituese në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
5. **Z. I.S<sup>6</sup>**, është person me aftësi të kufizuar i Grupit të I-rë dhe për vitin akademik 2025-2026 është student i vitit të parë, i regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Shërbim Social”, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfitues në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
6. **Z. S.Ç<sup>7</sup>**, është person me aftësi të kufizuar i Grupit të II-të dhe për vitin akademik 2025-2026 është student i vitit të parë, i regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Menaxhim Veterinar”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfitues në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
7. **Z. G.T<sup>8</sup>**, është person me aftësi të kufizuar, diagnostikuar me “Amputacion traumatik të anësive të poshtme, e paprotezuar”. Për vitin akademik 2025-2026 është student i vitit të dytë, i regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Teknika e prodhimit të farave e fidanëve”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e invaliditetit, ka qenë përfitues në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.

<sup>4</sup> Ankesa nr. 139 Regj/2026.

<sup>5</sup> Ankesa nr. 140 Regj/2026.

<sup>6</sup> Ankesa nr. 141 Regj/2026.

<sup>7</sup> Ankesa nr. 142 Regj/2026.

<sup>8</sup> Ankesa nr. 143 Regj/2026

8. **Znj. D.Ç<sup>9</sup>**, është person me aftësi të kufizuar dhe për vitin akademik 2025-2026 është studente e vitit të parë, e regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Menaxhim Biznesi Bujqësor”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Ajo ka qenë përfituese në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë, për periudhën Tetor-Qershor 2025 dhe Tetor-Janar 2026. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
9. **Z. A.Q<sup>10</sup>**, është person me aftësi të kufizuar. Për vitin akademik 2025-2026 është student i vitit të dytë, i regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Teknika e prodhimit të farave e fidanëve”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e invaliditetit, ka qenë përfitues në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
10. **Znj. R.A<sup>11</sup>**, është person me aftësi të kufizuar e Grupit të I-rë dhe për vitin akademik 2025-2026 është studente e vitit të dytë, e regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Teknika e prodhimit të farave e fidanëve”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfituese në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
11. **Znj. M.A<sup>12</sup>**, është person me aftësi të kufizuar e Grupit të II-të dhe për vitin akademik 2025-2026 është studente e vitit të dytë, e regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Teknika e prodhimit të farave e fidanëve”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfituese në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
12. **Znj. A.M<sup>13</sup>**, është person me aftësi të kufizuar dhe për vitin akademik 2025-2026 është studente e vitit të dytë, e regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Teknika e prodhimit të farave e fidanëve”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfituese në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.
13. **Znj. D.S<sup>14</sup>**, është person me aftësi të kufizuar e Grupit të I-rë dhe për vitin akademik 2025-2026 është studente e vitit të dytë, e regjistruar në programin e studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në “Teknika e prodhimit të farave e fidanëve”, pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Duke qenë se gëzon statusin e verbërisë, ka qenë përfituese në masën 300% të pagesës së aftësisë së kufizuar, për shkak të verbërisë, pagesë e dhënë nga

<sup>9</sup> Ankesa nr. 144 Regj/2026.

<sup>10</sup> Ankesa nr. 145 Regj/2026

<sup>11</sup> Ankesa nr. 148 Regj/2026.

<sup>12</sup> Ankesa me nr. 152 Regj/2026

<sup>13</sup> Ankesa nr. 159 Regj/2026

<sup>14</sup> Ankesa me nr. 169 Regj/2026

*ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në muajin shkurt 2026, i është ndërprerë kjo pagesë.*

Përfundimisht, ankuesit kërkojnë nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, si dhe përfitimin e pagesës mujore.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (në vijim LMD), që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesat e paraqitura janë në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar dhe u pranuan për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara në nenin 33, pika 4, të këtij ligji.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjet dhe ka ndërmarrë hapat si më poshtë:**

1. Me shkresat nr. 1060/1 prot., datë 05.06.2026; nr. 1077/1 prot., datë 23.06.2026; nr. 1082/1 prot., datë 10.06.2026; nr. 1093/1 prot., datë 12.06.2026; nr. 1094/1 prot., datë 19.06.2026; nr. 1095/1 prot., datë 24.06.2026; nr. 1096/1 prot., datë 12.06.2026; nr. 1109/1 prot., datë 17.06.2026; nr. 1110/1 prot., datë 19.06.2026; nr. 1136/1 prot., datë 23.06.2026; nr. 1147/1 prot., datë 23.06.2026; nr. 1211/1 prot., datë 29.06.2026 dhe nr. 1330/1 prot., datë 17.07.2026 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, duke kërkuar informacion të detajuar në lidhje me ankesat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesit, si dhe sqarime mbi procedurat e ndjekura për ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar në masën 300 %.
2. Me shkresat nr. 3006/1 prot., datë 26.06.2026<sup>15</sup>; nr. 3070/1 prot., datë 26.06.2026<sup>16</sup>; nr. 3232/1 prot., datë 29.06.2026<sup>17</sup>; nr. 3231/1 prot., datë 29.06.2026<sup>18</sup>; nr. 3287/1 prot., datë 01.07.2026<sup>19</sup>;

<sup>15</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1060/4 prot., datë 29.06.2026.

<sup>16</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1082/3 prot., datë 29.06.2026.

<sup>17</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1094/2 prot., datë 01.07.2026.

<sup>18</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1110/2 prot., datë 01.07.2026.

<sup>19</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1077/2 prot., datë 02.07.2026.

nr. 3315/1 prot., datë 08.07.2026<sup>20</sup> dhe nr. 3104/4 prot., datë 16.07.2026<sup>21</sup>, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka kthyer përgjigje, duke paraqitur informacion lidhur me situatën e ankuesve, duke informuar se:

*“Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale harton dhe zbaton politika për të garantuar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, bazuar në Ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” dhe legjislacionin në fuqi. Gjithashtu zbaton dokumentet strategjike kombëtare, nëpërmjet të cilave synohet përmirësimi i aksesit në arsim në të gjitha nivelet, rritja e mundësive për punësim dhe pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore, si dhe garantimi i aksesit të barabartë në shërbime dhe skema mbështetëse, në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit.*

*Legjislacioni sektorial parashikon edhe masa konkrete mbështetëse për personat me statusin e të verbrit, përfshirë trajtimin financiar në funksion të ndjekjes së arsimit. Konkretisht, Udhëzimi nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar, parashikon trajtim të diferencuar për nxënësit dhe studentët e verbër, duke përcaktuar përfitimin sipas pikave 7 dhe 8:*

*“7. Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurse të formimit profesional, vetëm për një shkollë, përfitojnë dyfishin e pagesës së përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997, i ndryshuar.*

*8. Studentët e verbër të shkollave të larta, ose që përfshihen në arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, ose të verbrit që kanë mbrojtur gradën “Doktor i shkencave”, përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997, i ndryshuar”.*

*Udhëzimi i sipërcituar ka parashikuar trajtimin me pagesë 200% të personave me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin e mesëm dhe kurset e formimit profesional dhe pagesë 300% kur ndjekin programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, ose kur kanë mbrojtur gradën Doktor i shkencave”.*

*Për sa më sipër, sqarojmë se pika 4 e nenit 70 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, parashikon: “Programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë dhe diploma profesionale, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve”. Sipas nenit 72, pika 1 programet e studimit me karakter profesional të institucioneve të arsimit të lartë, i referohen nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në përfundim të tyre lëshohet “Certifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer”.*

*Neni 73 i ligjit të sipërcituar parashikon se studentët që ndjekin programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome dhe në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer. Neni 75 i këtij Ligji, parashikon programet e ciklit të dytë të studimeve që përfshijnë “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studimet e ciklit*

<sup>20</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1095/3 prot., datë 09.07.2026.

<sup>21</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1096/4 prot., datë 16.07.2026.

*të dytë përmbyllen me provim përfundimtar/formim ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë në fushën e arsimimit të kryer”.*

3. Me shkresat nr. 5436/1 prot., datë 25.06.2026<sup>22</sup>; nr. 5578/1 prot., datë 25.06.2026<sup>23</sup>; nr. 5696/1 prot., datë 25.06.2026<sup>24</sup>; nr. 5697/1 prot., datë 25.06.2026<sup>25</sup>; nr. 5911/1 prot., datë 26.06.2026<sup>26</sup>; nr. 6117/1 prot., datë 07.07.2026<sup>27</sup>; nr. 6118/1 prot., datë 07.07.2026<sup>28</sup>; nr. 6182/1 prot., datë 09.07.2026<sup>29</sup>; nr. 6307/1 prot., datë 13.07.2026<sup>30</sup> dhe nr. 7010/1 prot., datë 30.07.2026<sup>31</sup>, Shërbimi Social Shtetëror, ka kthyer përgjigje, duke paraqitur informacion lidhur me situatën e ankuesve, duke informuar se:

*“Nga verifikimet e kryera në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar rezulton se subjektet ankues gëzojnë statusin e verbërisë. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Drejtoria Rajonale Korçë i është drejtuar institucionit të arsimit të lartë përkatës, nga ku është komunikuar se ankuesit ndjekin një program universitar studimi me karakter profesional pas arsimit të mesëm, që i përket nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, referuar Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Nga komunikimi me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë u bë me dije se ankuesit studentë në “Programet e studimit profesional 2- vjeçar me kohë të plotë”, kanë qenë përfitues në masën 300% për pagesën e aftësisë së kufizuar për periudhën Tetor 2023-Janar 2026 dhe prej muajit Shkurt 2026 e në vazhdim trajtohen me pagesën mujore, bazuar në shkresën e MSHMS-së Nr. 4982/1 prot., datë 26.01.2026.*

*Në Ligjin Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe VKM-në Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar përcaktohet se, personat përfitues të statusit të të verbërit përfitojnë një pagesë mujore në zbatim të vendimeve të Komisioneve mjekësore të përcaktimit të verbërisë (KMPV). Në rastet kur personat përfitues të statusit të të verbërit ndjekin arsimin e mesëm apo kurse të formimit profesional, përfitojnë pagesë shtesë në masën 200% dhe kur ndjekin programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë ose kur kanë mbrojtur gradën “Doktor i Shkencave”, përfitojnë pagesë shtesë në masën 300%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar. Konkretisht, pikat 7, 8 dhe 9 të këtij udhëzimi përcaktojnë:*

*... “7. Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurse të formimit profesional, vetëm për një shkollë, përfitojnë dyfishin e pagesës së përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997, i ndryshuar.*

*8. Studentët e verbër të shkollave të larta, ose që përfshihen në arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, ose të verbrit që kanë mbrojtur gradën “Doktor i shkencave”,*

<sup>22</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1060/3 prot., datë 26.06.2026.

<sup>23</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1082/2 prot., datë 26.06.2026.

<sup>24</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1093/2 prot., datë 26.06.2026.

<sup>25</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1096/2 prot., datë 26.06.2026.

<sup>26</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1109/2 prot., datë 01.07.2026.

<sup>27</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1136/2 prot., datë 08.07.2026.

<sup>28</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1077/3 prot., datë 08.07.2026.

<sup>29</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1095/2 prot., datë 13.07.2026.

<sup>30</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1211/2 prot., datë 14.07.2026.

<sup>31</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1330/3 prot., datë 03.08.2026.

përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997, i ndryshuar”.

9. Për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, të verbrit nxënës, që vazhdojnë shkollat e mesme, të larta dhe arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, kanë të drejtë të marrin pagesën e verbërisë deri në përfundimin e ciklit shkollor. Pagesa që përfiton i verbri për gradën “Doktor i shkencave”, është e përhershme”.

Lidhur me kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojë një student me statusin e të verbërit për të përfituar pagesën për shkak të verbërisë sqarojmë se, në pikat 10, 10/1 dhe 11 të të njëjtit udhëzim përcaktohet dokumentacioni që duhet të administrohet në dosje nga administratorët shoqërorë pranë bashkive/njërive administrative, si më poshtë vijon:

10. Të verbrit që vazhdojnë shkollën e mesme, të lartë, arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, duhet të paraqesin këto dokumente:

- a) Vërtetim të firmosur nga titullari dhe sekretari i shkollës, i cili të përmbajë emrin e përfituesit, llojin e arsimit që ndjek, vitin shkollor, nëse është cikël normal me korrespondencë apo i përsëritur.
- b) Vërtetim të firmosur nga titullari dhe sekretari i shkollës për frekuentimin e shkollës nga përfituesi për çdo 3 muaj, për të verbrit që vazhdojnë shkollën me korrespondencë të paraqitet vërtetimi që ka shlyer detyrimet para çdo sezoni.
- c) Kopjen e noterizuar të dëftesës së shkollës të çdo viti për shkollën e mesme dhe kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së lartë.

10/1. Dokumentacioni për ndjekjen e arsimit të mesëm të lartë merret nëpërmjet ndërveprimit mes Regjistrat kombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP).

11. Të verbërit që ndjekin kurset e formimit profesional për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, duhet të paraqesin këto dokumente:

- a) Vërtetim nga institucioni që organizon kursin, ku të jetë përcaktuar emri i kursantit, lloji i kursit dhe kohëzgjatja e tij;
- b) Vërtetim për frekuentimin e kursit, kur ai zgjat mbi 6 muaj, vërtetimi paraqitet çdo 3 muaj;
- c) Kopja e noterizuar e dëshmisë së kursit në mbarim të tij”.

Referuar faktit se “Programet e studimit me karakter profesional”, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë nuk janë të përfshirë shprehimisht në pikat 7 dhe 8 të Udhëzimit Nr. 2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ka patur paqartësi lidhur me mënyrën se si duhet të trajtohen këto subjekte nga pikëpamja e përfitimit financiar.

Nisur nga shkresa Nr. 124/1 Prot, datë 08.11.2025 të Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, protokolluar pranë Shërbimit Social Shtetëror me Nr. 9375 Prot, datë 17.11.2025 lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 8098 “Për statusin e të Verbërit”, i ndryshuar, shkresa Nr. 4082 Prot. datë 09.12.2025 dërguar nga Bashkia Devoll, protokolluar me Nr. 1008 Prot, datë 09.12.2025 si dhe kërkesave të vazhdueshme të njërive të vetëqeverisjes vendore, lidhur me pagesat që përfitojnë personat me status Verbëri për programet studimore me karakter profesional, të cilat kryhen në institucionet e arsimit të lartë pas përfundimit të arsimit të mesëm, Shërbimi Social Shtetëror ka

dërguar pranë MSHMS-së shkresën Nr. 10018/1 prot., datë 19.12.2025 me objekt “Kërkesë për sqarim” lidhur me unifikimin e praktikës nga njësitë administrative për trajtimin financiar që përfitohet për programet studimore me karakter profesional.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror ka administruar shkresën me Nr. 4982/1 prot., datë 26.01.2026 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, protokolluar me Nr. 10018/2, datë 27.01.2026, e cila u është përcjellë për njohje dhe zbatim 12 Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, në mënyrë që të merren masat e nevojshme administrative dhe procedurale për zbatimin e kuadrit ligjor dhe udhëzimeve përkatëse në fuqi.

Lidhur me faktin nëse ka një regjistër apo listë zyrtare të përfituesve aktivë të pagesës mujore për studentët me statusin e të verbërit sqarohet se, në pikën 16, të Udhëzimit Nr. 2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar përcaktohet se:

16. Dokumentacioni i dosjes së përfituesit që është vlerësuar nga KMPV-ja, hidhet në arkivin elektronik brenda afateve dhe sipas rregullave të detajuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe më pas dërgohet pranë njësisë administrative së bashku me njoftimin për vendimin për çdo person.

Dosja e përfituesit dërgohet zyrtarisht pranë njësisë administrative së bashku me vërtetimin për vendimin, vendimin e KMPV-së dhe librezën e verbërisë të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror. Një kopje e vendimit të KMPV-së ruhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror”.

Për sa më sipër, nisur nga fakti se administrimi i dokumentacionit dhe ekzekutimi i pagesave për përfituesit e statusit të të verbërit realizohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për rrjedhojë lista e përfituesve të pagesës mujore për përfituesit e statusit të të verbërit ndodhet pranë këtyre njësive”.

Lidhur me rastet e shtetasve G.T dhe A.Q, Shërbimi Social Shtetëror sqaroi ndër të tjera se: “Nga verifikimi i kryer në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar rezulton se shtetasit gëzojnë statusin e personave me aftësi të kufizuar. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Drejtoria Rajonale Korçë, i është drejtuar institucionit të arsimit të lartë përkatës, nga ku është komunikuar se këta shtetas ndjekin një program universitar studimi me karakter profesional pas arsimit të mesëm, që i përket nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, referuar Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Nga komunikimi me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë u bë me dije se këta shtetas, janë studentë në “Programet e studimit profesional 2-vjeçar me kohë të plotë” dhe kanë qenë përfitues në masën 300% për pagesën e aftësisë së kufizuar për periudhën Tetor 2025 - Janar 2026 dhe prej muajit Mars 2026 e në vazhdim trajtohen me pagesën mujore, bazuar në shkresën e MSHMS-së Nr. 4982/1 prot., datë 26.01.2026...

Në Ligjin Nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë dhe VKM në Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, i ndryshuar, përcaktohet se, personat me aftësi të kufizuar përfitojnë një pagesë mujore në zbatim të vendimeve të Komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Në rastet kur personat përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar ndjekin arsimin e mesëm të lartë, arsimin e lartë apo kurse kualifikimi të licencuar ose të

akredituar, përfitojnë pagesë shtesë në masën 200% ose 300%, konkretisht në Kreun IV, pikat 8 dhe 9 të VKM-së Nr. 722/2019 përcaktojnë:

8. Personat me aftësi të kufizuara, që ndjekin një kurs kualifikimi të licencuar ose të akredituar dhe nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin kursin/shkollën vetëm për një dhe gjatë një kursi kualifikimi/programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e kursit të kualifikimit/programit të studimit.

9. Studentët, të cilët ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit. E njëjta masë pagese zbatohet për personal që ndjekin programin e studimit të ciklit të tretë. Për personat që ndjekin studimet e doktoratës dhe për personat që ndjekin procedurat për fitimin e një titulli akademik, kjo pagesë përfitohet në mënyrë të përhershme, mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente për fitimin e gradës shkencore/titullit akademik”.

Lidhur me kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë personat me aftësi të kufizuara për të përfituar pagesën për ndjekjen e arsimit sqarojmë se, në pikat 11 dhe 12 të të njëjtit vendim përcaktohet dokumentacioni që duhet të administrohet në dosje nga administratorët shoqërorë pranë bashkive/njësive administrative, si më poshtë vijon:

“11. Personal me aftësi të kufizuara, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, paraqesin për çdo fillim të vitit shkollor/akademik dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetimin e nënshkruar nga titullari dhe sekretari i institucionit arsimor të mesëm të lartë dhe të lartë, ku shënohet emri dhe mbiemri i personit, niveli i arsimit që ndjek, viti shkollor/akademik dhe kohëzgjatja. Për të vërtetuar frekuentimin e procesit mësimor vërtetimi lëshohet çdo tre muaj. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të çdo sezoni lëshohet vetëm për personat që ndjekin arsimin e lartë;

b) kopjen e noterizuar të dëftesës së çdo viti, kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së mesme të lartë apo të lartë dhe/ose kopje të dëshmisë së kursit të kualifikimit.

12. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë fituar gradë shkencore/titull akademik paraqesin kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore/titullit akademik...”

4. Me shkresat nr. 868/1 prot., datë 08.06.2026<sup>32</sup>; nr. 883/1 prot., datë 26.06.2026<sup>33</sup>; nr. 905/1 prot., datë 26.06.2026<sup>34</sup>; nr. 981/3 prot., datë 08.07.2026<sup>35</sup>; nr. 905/1 prot., datë 26.06.2026<sup>36</sup>; nr. 927/2 prot., datë 26.06.2026<sup>37</sup>; nr. 936/3 prot., datë 02.07.2026<sup>38</sup>; nr. 959/3 prot., datë 02.07.2026<sup>39</sup>; nr. 959/3 prot., datë 02.07.2026<sup>40</sup>; nr. 959/3 prot., datë 02.07.2026<sup>41</sup>; nr. 991/3

<sup>32</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1060/2 prot., datë 11.06.2026.

<sup>33</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1082/4 prot., datë 02.07.2026.

<sup>34</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1093/3 prot., datë 02.07.2026.

<sup>35</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1095/5 prot., datë 13.07.2026.

<sup>36</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1096/3 prot., datë 02.07.2026.

<sup>37</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1109/3 prot., datë 02.07.2026.

<sup>38</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1110/3 prot., datë 09.07.2026.

<sup>39</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1136/3 prot., datë 09.07.2026.

<sup>40</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1147/2 prot., datë 09.07.2026.

<sup>41</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1077/4 prot., datë 09.07.2026.

prot., datë 10.07.2026<sup>42</sup>; dhe nr. 1098/2 prot., datë 30.07.2026<sup>43</sup>, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë, ka kthyer përgjigje, duke mbajtur të njëjtin qëndrim dhe parashtrime me Shërbimin Social Shtetëror.

5. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi shqyrtoi tërësinë e ankesave të paraqitura, vendosi bashkimin e tyre në një vendimmarrje të vetme, bazuar në arsyet e mëposhtme faktike dhe juridike.

Nga pikëpamja faktike, rezultoi se të gjithë ankuesit ndodhen në të njëjtat rrethana materiale: janë persona me aftësi të kufizuara dhe ndjekin programe studimi “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë.

Shqyrtimi i thelbit të çdo ankese zbuloi se, pavarësisht ndryshimeve në rrethanat personale të secilit subjekt ankues, baza e përbashkët e pretendimeve është identike: aftësia e kufizuar si shkak i vetëm dhe vendimtar që i ka çuar ankuesit në situatën e ankimuar pranë Komisionerit.

Nga pikëpamja juridike, Komisioneri ka parasysh se bashkimi i çështjeve në një vendimmarrje të vetme është i justifikuar kur ankesat kanë të njëjtin subjekt pasiv, të njëjtat rrethana juridike dhe faktike, të njëjtin shkak diskriminimi dhe pretendojnë të njëjtin lloj trajtimi të padrejtë.

Në rastin konkret, të gjitha këto kushte plotësohen njëkohësisht: subjektet pasive janë të njëjta, MSHMS, SHSSH dhe DRSHSSH Korçë; rrethanat juridike dhe faktike janë substancialisht të njëjta; shkak i pretenduar i diskriminimit është i përbashkët aftësia e kufizuar; dhe trajtimi i ankimuar është i njëjtë, ndërprerja e pagesës në masën 300% duke filluar nga muaji shkurt 2026 nga DRSHSSH Korçë. Bashkimi i ankesave garanton koherencën e vlerësimit juridik, shmang kundërthëniet e mundshme në arsyetim dhe siguron trajtim të barabartë e të unifikuar të situatave substancialisht të njëjta, në përputhje me parimet e ekonomisë procedurale dhe të sigurisë juridike.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë**

Nga faktet dhe provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjeve rezultoi se ankuesit ndodhen në një situatë faktike dhe juridike të njëjtë, çka bën të mundur trajtimin e tyre së bashku në një vendim të vetëm.

Mbështetur në informacionin e vënë në dispozicion nga palët, rezultoi se ankuesit janë persona me aftësi të kufizuara, të verbër dhe/ose invalid, të vërtetuar nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar, dhe për vitin akademik 2025-2026 janë të regjistruar, si studentë të vitit të parë ose të dytë, në programe studimi “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane (dega Shërbim Social) dhe pranë Fakultetit të

<sup>42</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1211/3 prot., datë 17.07.2026.

<sup>43</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1330/2 prot., datë 03.08.2026.

Bujqësisë (degët Teknika e prodhimit të farave e fidanëve, Menaxhim Biznesi Bujqësor, Menaxhim Veterinar), të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.

Deri në muajin shkurt 2026, ankuesit kanë qenë përfitues të pagesës shtesë në masën 300% të pagesës për shkak të verbërisë, e administruar dhe e shpërndarë nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë. Në zbatim të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) Nr. 4982/1 prot., datë 26.01.2026, DRSHSSH Korçë ka ndërprerë pagesën në masën 300% duke filluar nga muaji shkurt 2026.

Ankuesit pretendojnë se ndërprerja e kësaj pagese përbën trajtim të padrejtë, të pafavorshëm dhe diskriminues për shkak të “aftësisë së kufizuar”, pasi statusi i tyre i verbërisë dhe cilësia e studentit nuk kanë ndryshuar, dhe kërkojnë rikthimin e pagesës në masën e mëparshme prej 300%.

Sipas nenit 70, pika 4, të Ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, programet e studimeve në arsimin e lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme (cikli i parë, i dytë dhe i tretë), referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, ndërkohë që diplomat/certifikatat profesionale, sipas nenit 72, pika 1, të po këtij ligji, i referohen nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si nivel i veçantë dhe i dallueshëm nga ciklet universitare.

Udhëzimi nr. 2365, datë 26.11.2008 *“Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997 ‘Për përfitimet nga statusi i të verbrit’*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht, në pikat 7 dhe 8, dy kategori të ndryshme përfitimi: pika 7, përcakton se nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurset e formimit profesional, përfitojnë pagesë shtesë në masën 200% dhe pika 8, përcakton se studentët e verbër që ndjekin programet e ciklit të parë ose të dytë të arsimit të lartë (nivelet 6 dhe 7 të Kornizës), ose që kanë mbrojtur gradën “Doktor i shkencave”, përfitojnë pagesë shtesë në masën 300%.

Nga informacioni i administruar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe MSHMS rezulton qartazi se programi “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë”, i ndjekur nga të gjithë ankuesit, është një program studimi me karakter profesional, që i referohet shprehimisht nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe jo cikleve të para apo të dyta të arsimit të lartë (nivelet 6 dhe 7), të cilat i takojnë vetëm programeve Bachelor dhe Master.

Për të konstatuar ekzistencën e diskriminimit, Komisioneri duhet të verifikojë nëse ankuesit janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme krahasuar me persona që ndodhen në një situatë të krahasueshme, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, ose nëse janë trajtuar në mënyrë të njëjtë me persona që ndodhen në situata thelbësisht të ndryshme, pa justifikim.

Në rastin konkret, kriteri që përcakton masën e përfitimit (200% ose 300%) sipas Udhëzimit nr. 2365/2008 nuk lidhet me statusin e verbërisë të vetë personit, i cili mbetet i njëjtë për të gjithë përfituesit, por me nivelin dhe natyrën e programit arsimor që ndiqet, referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studentët që ndjekin programe të ciklit të parë ose të dytë (nivelet 6-7) ndodhen në një situatë juridikisht të ndryshme nga personat që ndjekin programe profesionale të nivelit 5, pasi janë të rregulluara nga dispozita të veçanta ligjore (Ligji nr. 80/2015) dhe përfundojnë me tituj akademikë të ndryshëm (Bachelor/Master përkundrejt Diplomë/Certifikatë profesionale që përfitojnë ankuesit).

Ankuesit, duke qenë të regjistruar në programe të nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, nuk ndodhen në një situatë të krahasueshme me studentët e ciklit të parë ose të dytë të arsimit të lartë, për të cilët Udhëzimi nr. 2365/2008 parashikon pagesën shtesë prej 300%. Për rrjedhojë, trajtimi i tyre i ndryshëm nga ky grup krahasues bazohet në një kriter objektiv (niveli i programit të studimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve) dhe jo në statusin e tyre të verbërisë apo në ndonjë karakteristikë tjetër të mbrojtur, çka përjashton ekzistencën e një trajtimi diskriminues për shkak të “aftësisë së kufizuar”, në kuptim të nenit 1 dhe nenit 7 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ndërprerja e pagesës shtesë prej 300% dhe trajtimi i ankuesve sipas parashikimeve përkatëse për programet e nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, nuk përbën diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Neni 1 i Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), përcakton si qëllim të ligjit realizimin e barazisë ndaj çdo personi, ndër të tjera, për shkak të aftësisë së kufizuar. Neni 3, pika 1, e LMD përkufizon diskriminimin e drejtpërdrejtë si çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë e bazuar në një shkak të mbrojtur, ndërsa pika 2 e po këtij neni përkufizon diskriminimin e tërthortë si vendosjen e një dispozite, kriteri apo praktike, në dukje neutrale, që vë personat me një shkak të mbrojtur në një pozitë të pafavorshme krahasuar me persona të tjerë, përveçse kur ajo dispozitë, kriter apo praktikë objektivisht justifikohet nga një qëllim i ligjshëm.

Nga provat e administruara, rezultoi se vetë institucionet e administratës (Shërbimi Social Shtetëror dhe MSHMS) kanë pranuar shprehimisht se programet e studimit profesional 2-vjeçar, të ofruara nga institucione të arsimit të lartë, nuk përfshihen në mënyrë të shprehur as te pika 7 as te pika 8 e Udhëzimit nr. 2365/2008, ku pika 7 mbulon nxënës të shkollës së mesme/kurseve të formimit profesional (jo institucione të arsimit të lartë), ndërsa pika 8 mbulon vetëm ciklin e parë/të dytë (jo diplomat profesionale të nivelit 5).

Përveç kuadrit ligjor specifik për personat me status verbërie, rezultoi gjatë shqyrtimit se Shërbimi Social Shtetëror ka sqaruar se ankuesit G.T dhe A.Q gëzojnë statusin e personit me aftësi të kufizuar (jo status verbërie), dhe se trajtimi i tyre financiar rregullohet nga një kuadër i veçantë ligjor: Ligji nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitim të aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, i ndryshuar.

Sipas Kreut IV, pikave 8 dhe 9, të VKM-së nr. 722/2019, personat me aftësi të kufizuar që ndjekin një kurs kualifikimi të licencuar/akredituar ose arsimin e mesëm të lartë, përfitojnë pagesë shtesë në masën 200%, ndërsa studentët që ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë, të dytë ose të tretë, përfitojnë pagesë shtesë në masën 300%. Kjo strukturë përfitimi (200%/300%) është, në thelb, analoge me atë të parashikuar nga Udhëzimi nr. 2365/2008 për personat me status verbërie, dhe paraqet të njëjtin interpretim: as pika 8 as pika 9 e VKM-së nr. 722/2019 nuk përfshin shprehimisht programet e studimit profesional 2-vjeçar (niveli 5 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve), të cilat nuk përbëjnë as “kurs kualifikimi”/arsim të mesëm të lartë, as program të ciklit të parë, të dytë apo të tretë të arsimit të lartë.

Për konstatimin e diskriminimit, LMD kërkon plotësimin kumulativ të elementëve: (i) ekzistencën e një trajtimi më pak të favorshëm ose të një kriteri në dukje neutral me efekt të pabarabartë; (ii) ekzistencën e një grupi krahasues në situatë të krahasueshme; dhe (iii) mungesën e një justifikimi objektiv e të arsyeshëm, të bazuar në një qëllim të ligjshëm dhe proporcional me të. Sipas nenit 34 të LMD, kur ankuesi paraqet fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, barra e provës i kalon palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, e cila duhet të provojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

Standardi i mësipërm përfshin edhe parimin sipas të cilit mosdiskriminimi mund të konstatohet edhe kur dy persona, që përndryshe ndajnë një karakteristikë të mbrojtur (p.sh. aftësinë e kufizuar), trajtohen ndryshe për shkak se ndodhen, për arsye objektive, në situata faktike/juridike thelbësisht të ndryshme nga njëra-tjetra.

Duke aplikuar këtë standard në rastin konkret, Komisioneri vëren se ankuesit nuk ndodhen në një situatë të krahasueshme me studentët e ciklit të parë/të dytë të arsimit të lartë, prandaj mospërfitimi i pagesës 300% nuk përbën diskriminim ndaj tyre krahasuar me këtë grup.

Për sa i përket ankuesve G.T dhe A.Q, nga parashtrimet shtesë të Shërbimit Social Shtetëror rezultoi se ata gëzojnë statusin e personit me aftësi të kufizuar (dhe jo status verbërie), çka konfirmohet edhe nga verifikimi në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar. Trajtimi financiar i tyre rregullohet për rrjedhojë nga Ligji nr. 57/2019 dhe VKM nr. 722/2019, dhe jo nga Udhëzimi nr. 2365/2008 (i cili mbetet i aplikueshëm vetëm për personat me status verbërie). Nga administrimi i çështjes rezultoi se edhe këta dy ankues kanë qenë përfitues të pagesës shtesë 300% për periudhën Tetor 2025 - Janar 2026, dhe se, në zbatim të shkresës së MSHMS-së nr. 4982/1 prot., datë 26.01.2026, kjo pagesë shtesë u është ndërprerë duke filluar nga muaji Mars 2026. Duke qenë se programi i studimit “Profesional 2-vjeçar me kohë të plotë” i përket nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, e jo cikleve të para, të dyta apo të treta të arsimit të lartë të parashikuara nga pika 9 e VKM-së nr. 722/2019, arsyetimi i paraqitur edhe për pjesën tjetër të ankuesve më sipër zbatohet njësoj edhe për këta dy ankues: kriteri që përcaktoi ndërprerjen e pagesës shtesë është niveli i programit të studimit, dhe jo statusi i tyre i aftësisë së kufizuar, çka përjashton ekzistencën e diskriminimit edhe në rastin e tyre.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, dhe në mungesë të provave që të vërtetojnë se ankuesit janë trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se persona të tjerë në një situatë të krahasueshme, në kushtet kur kriteri i zbatuar rezulton objektiv, i parashikuar me ligj dhe i zbatuar në mënyrë të njëtrajtshme ndaj të gjithë përfituesve në situatë të ngjashme, Komisioneri gjykon se subjektet ankuese nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri konkludon se nuk konstatohet një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror ndaj subjekteve ankuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, siç pretendohet nga këto të fundit, dhe për rrjedhojë nuk provohet se subjektet e sipërcituara kanë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesve D.L, R.B, M.G, N.M, I.S, S.Ç, G.T, D.Ç, A.Q, R.A, M.A, A.M dhe D.S, nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimi Social Shtetëror, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, në lidhje me ndërprerjen e pagesës shtesë prej 300% dhe trajtimin financiar sipas programit të studimit që ndjekin, i cili i përket nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (BUNGO)**